

KONKURS PËR PUNË

Pozita: Këshilltar ligjor

Vendi: Handikos HQ, Prishtinë

HANDIKOS (Shoqata e Paraplegjikëve dhe Pararalizës së Fëmijëve të Kosovës) është themeluar në vitin 1983 me qëllim të arritjes së njohjes së plotë dhe pjesëmarrjes së personave me aftësi të kufizuara në shoqëri. HANDIKOS në vazhdimësi lobon dhe avokon në nivel lokal dhe qendror për të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara. Në kuadër të përpjekjeve tona për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe për të avancuar realizimin e të drejtave të njeriut të fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara, HANDIKOS po kërkon të angazhojë një Këshilltar Ligjor.

Përshkrimi i punës:

Handikos ju ofron mundësi punësimi për kohë të gjatë, dhe me mundësi të shkëlqyeshme për karrierë të suksesshme dhe zhvillim personal për persona ambicioz, të përkushtuar dhe me standarde të larta profesionale. Këshilltari ligjor do të luajë një rol të rëndësishëm në iniciimin, përmirësimin, dhe implementimin e kornizës ligjore për personat me aftësi të kufizuara.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofron këshilla dhe shërbime ligjore për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim të realizimit të të drejtave dhe përfitimeve nga legjislacioni, ku përfshihen hartimi i kërkesave, ankesave dhe padive;
- Ofron këshilla dhe shërbime ligjore për të drejtat dhe përgjegjësitë e organizatës, që përfshin hartimin e kontratave, hartimin e kërkesave dhe ankesave, hartimi e padive dhe akteve të ndryshme për organizatën;
- Inicon dhe ndihmon organizatën në përgatitjen e komenteve dhe rekomandimeve gjatë konsultimeve publike për projektligje dhe projekt akte të ndryshme;
- Monitoron zbatimin e kornizës ligjore që ndërlidhet me fushën e aftësisë së kufizuar;
- Ndihmon në analizimin e politikave për të cilat ofron rekomandime për temat e avokimit;
- Kryen shërbime administrative si protokollim dhe arkivim të shkresave, ruajtje dhe mirëmbajtje të dosjeve të stafit dhe dosjeve tjera;
- Merr pjesë në përgatitjen dhe zhvillimin e aktiviteteve të projekteve sipas planit të projekteve dhe kërkesave nga mbikëqyrësi;
- I punësuari kryen edhe punë dhe detyra tjera sipas nevojave të organizatës.

Përvoja dhe kualifikimet e kërkua:

- Diplomë në Juridik;
- Së paku 1 vit përvojë pune në pozitë të ngjashme (përparësi kanë kandidatët e familjarizuar në fushën e të drejtave të njeriut;
- Njohje e proceseve të inicimit dhe miratimit të ligjeve dhe akteve nënligjore;
- Aftësi të mira përfaqësimi dhe në të folur në publik;
- Aftësi të mira analitike dhe komunikimi në gjuhën shqipe dhe angleze (verbale dhe në të shkruar);
- Njohuri të avancuara në përdorimin e programeve të Microsoft Office.

Aplikimi:

Kandidatët e interesuar luten të dorëzojnë CV dhe një letër motivuese në rinor.gashi@handi-kos.org dhe handikos@handi-kos.org, jo më larg se: 7 Korrik 2017, ora 16:00. Vetëm kandidatët që zgjedhën në listën e ngushtë do të ftohen për intervistë.